



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

DREJTORIA E KUJDESIT SOCIAL

RELACION

Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i buxhetit vendor, për vitin 2024.

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, Ligjit nr.57/2019“Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, Neni 21, Udhëzimit nr. 5, datë 17.02.2017, pika 2, udhëzimit nr.8 datë 08.05.2017, V.K.M Nr.597, datë 04.09.2019, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, Ligjit nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 97 datë 07.12.2023“Për buxhetin e vitit 2024”.

Është e drejta e Drejtorisë së Kujdesit Social, të përzgjedhë, një numër familjesh nga kategoritë më në nevojë dhe të trajtojë ato me ndihmë ekonomike, nga buxheti i Bashkisë. Këto familje përzgjidhen nga aplikantët e listës së familjeve jo përfituese.

Për këto familje, duhet të kryhet detyrimisht kontrolli nëbanesë dhe të shoqërohet me një vlerësim social-ekonomik nga një komision i përbërë prej tre administratorë shoqërorë të Drejtorisë së Kujdesit Social dhe Përgjegjësit të Pagesave.

Përfitues të fondit nga buxheti i Pushtetit Vendor do të jenë, familjet të cilat nuk kanë përfituar nga sistemi i pikëzimit dhe nga 6% i fondit të kushtëzuar. Por kualifikohen si përfitues për shkak të kushteve shumë të vështira social-ekonomike dhe vështirësive të veçanta sociale.

Lista e familjeve do të miratohen me vendim të Këshillit Bashkiak në bazë të kriterëve specifike që propozohen në Projekt-Vendim dhe që janë përcaktuar duke marrë parasysh situatën konkrete social-ekonomike të disa nën/kategorive.

*Drejtoreshë Përgjithshme e Drejtorisë Drejtor i Kujdesit Social
Juridike dhe Burimeve Njerëzore*

Anxhela Qeramixhi(Dishnica)Mariana Jorgji

Kryetari i Bashkisë

Sotiraq Filo



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

KESHILLI BASHKIAK

P/VENDIM

Nr. _____ datë _____ 2024

Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i buxhetit vendor për vitin 2024.

Duke u mbështetur në Ligjin nr.139, datë 17.12.2015, “Për vetë qeverisjen vendore”, Ligjin nr.9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 97 datë 07.12.2023, “Për buxhetin e vitit 2024, Ligji nr.57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, neni 21, të Udhëzimeve nr. 3, 4, 5,8 datë 17.02.2017, pika 2, të Ministrisë së Mirëqënies Sociale, V.K.M Nr.597, datë 04.09.2019, dhe Vendimit Nr.868, datë 29.12.2021 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Administratorët Shoqërorë të Drejtorisë së Kujdesit Social të Bashkisë Korçë, i propozojnë Këshillit të Bashkisë.

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1-Miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i buxhetit vendor si më poshtë vijon:

Përfitues të fondit nga buxheti i Pushtetit Vendor do të jenë:

1. Familjet të cilat kanë aplikuar për Ndhmë Ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur si fituese nga sistemi i pikëzimit.
2. Familja para se të përzgjidhet për tu trajtuar me këtë fond, duhet të jetë verifikuar paraprakisht dhe do të vlerësohen nga një komision i ngritur nga Administratorët Shoqëror dhe Përgjegjësit të Pagesave.
3. Familja duhet të jetë familje në nevojë, të jetë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
4. Familje me k/familjarë të ve ose divorcuar me të paktën një fëmijë që ndjek arsimin bazë ose të lartë.
5. Familje të cilat kanë fëmijë në moshë madhore, me probleme të ndryshme sociale (përdorues të lëndëve narkotike, probleme me ligjin etj.) të cilët kanë vështirësi punësimi.

6. Familje rome-egjiptiane të cilat kanë probleme me transferimin dhe regjistrimin.
7. Familjet me një anëtar që nuk kanë të ardhura ose i kanë të pamjaftueshme.
8. Familje me anëtar në moshë mbi 60-vjeç të cilët kanë në përbërje anëtar mbi moshë pune përfitues të një pensioni pleqërie.
9. Familje në varfëri ekstreme në rast fatkeqësie në pamundësi të përballimit të shpenzimeve.
10. Rastet kur k/familjari ose edhe anëtarë të tjerë madhorë janë të paaftë për të punuar,por për shkak të legjislacionit nuk përfitojnë pagesë Paaftësie.

2-Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Financës

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

K R Y E T A R

Eva NAÇI

Ana Verushi

Miratuar me _____vota
Vota Pro _____
Vota Kundër _____
Vota Abstenim _____
Zbardhur më datë _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

KESHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. _____ datë _____ 2024

Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike, nga fondi i buxhetit vendor për vitin 2024.

Duke u mbështetur në Ligjin nr.139, datë 17.12.2015, “Për vetë qeverisjen vendore”, Ligjin nr. 9936 dt.26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 97 datë 07.12.2023, “Për buxhetin e vitit 2024, Ligji nr.57/2019, “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, neni 21, të Udhëzimeve nr. 3, 4, 5,8 datë 17.02.2017, pika 2, të Ministrit të Mirëqënies Sociale, V.K.M Nr.597, datë 04.09.2019, dhe Vendimit Nr.868, datë 29.12.2021 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të Ndhmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, Administratorët Shoqërorë të Drejtorisë së Kujdesit Social të Bashkisë Korçë, i propozojnë Këshillit të Bashkisë.

KËSHILLI BASHKIAK

VENDOSI:

1-Miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike , nga fondi i buxhetit vendor si më poshtë vijon:

Përfitues të fondit nga buxheti i Pushtetit Vendor do të jenë:

1. Familjet të cilat kanë aplikuar për Ndhmë Ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur si fituese nga sistemi i pikëzimit.
2. Familja para se të përzgjidhet për tu trajtuar me këtë fond, duhet të jetë verifikuar paraprakisht dhe do të vlerësohen nga një komision i ngritur nga Administratorët Shoqëror dhe Përgjegjësit të Pagesave.
3. Familja duhet të jetë familje në nevojë dhe pa të ardhura.
4. Familje me k/familjarë të ve ose divorcuar me të paktën një fëmijë që ndjek arsimin bazë ose të lartë.
5. Familje të cilat kanë fëmijë në moshë madhore, me probleme të ndryshme sociale (përdorues të lëndëve narkotike, dhunë në familje, divorci, probleme shëndetësore, probleme me dokumentacionin në përmbushje të kriterëve që përcakton ligji Nr.57 /2029 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”) .
6. Familje rome-egjiptiane të cilat kanë probleme me transferimin dhe regjistrimin.
7. Familjet me një anëtar që nuk kanë të ardhura.

8. Familje me anëtar në moshë mbi 60-vjeç të cilët kanë në përbërje anëtar mbi moshë pune dhe në pamundësi punësimi.
9. Familje në varfëri ekstreme në rast fatkeqësie në pamundësi të përballimit të shpenzimeve.
10. Rastet kur k/familjari ose edhe anëtarë të tjerë madhorë janë të paaftë për të punuar,por për shkak të legjislacionit nuk përfitojnë pagesë Paaftësie.

2-Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Kujdesit Social dhe Drejtoria e Përgjithshme e Financës, buxhetit dhe MFK

3- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak

K R Y E T A R

Eva NAÇI

Ana Verushi

Miratuar me _____vota
Vota Pro _____
Vota Kundër _____
Vota Abstenim _____
Zbardhur më datë _____